

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ' SH.P.S.F'
"RRAJA SECURITY " SH.P.K.

KREU I

Dispozita te Pergjithshme

Sot, në datën 06.10.2021 (dymije e nezet e nje) personi meposhtem :

Z XHELAL RRAJA , /I biri I Rexhepit , shtetas Shqiptar, lindur në ZEZE

me ne 13.04. 1958, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, per identitetin e te cilit u garantova me ane te Kartes se Identitetit me numer personal ; **F80413008 Q**

ne cilesine e "Ortakut Themelues", me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe iniciativen e lire private, mbeshetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Ligjin Nr. 9901,dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare"; (I ndryshuar); Ligjin nr.9723,date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit"(I ndryshuar); Ligjin Nr.75/2014, 'PËR SHËRBIMIN PRIVAT TË SIGURISË FIZIKE'; dhe aktet e tjera nenligjore ne fuqi (I ndryshuar), vendosi te themeloje shoqerine tregtare "**SH.P.S.F**" , "**RRAJA SECURITY "** **SH.P.K.**

KREU II

Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore

Neni 1

EMRI

- **Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas forms "SH.P.S.F"**
- **Dhe mban emrin ""RRAJA SECURITY " SH.P.K.**
- 1. **Kapitali i shoqërisë me përgjigjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga cdo ortak në shoqërin. Cdo ortak zotëron një kuotë të vetme nëshoqëri.**

Neni 2

Objekti

Shoqëria **SH.P.S.F" RRAJA SECURITY " SH.P.K.**do te kete objekt veprimtarie :

Kryjen e shërbimeve të kategorisë 1.3.A të përcaktuara në nr.75/2014, “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” I ndryshuar si më poshtë :

“Sigurimi fizik i objekteve shtetërore e private, i personave, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike”, e cila ushtrohet në të gjithë territorin e veçdit”.

Shoqëria mund të kryejë dhe çdo lloj veprimtarie tjetër ligjore pakufizim të lidhur me aktivitetin sa më sipër në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3 **Kohezgjatja**

- 3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar, me përjashtim të rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumit përket vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqëria **SH.P.S.F”RRAJA SECURITY ” SH.P.K.** gëzon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tillë në regjistrin tregtar të QKR-se.

Neni 4 **Zyra Qendrore**

- 4.1 **Zyra qendrore e shoqërisë** ndodhet në adresën :Rruga Aeroport –Rinas km.1 Rinas, Objekt nr.pasurie 20/3, zk.3183, vol.3, faqe 235.
- 4.2 **Gjate veprimtarisë së saj, shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe hapëdege, filial dhe/ose zyra perfaqesimi edhe në qytetet e tjera, Brenda dhe/ose jashtë territorit në fuqi sipas juridiksionit të vendit përketes.**

KREU III

Neni 5 **Vlera dhe pagesat e kapitalit të regjistruar**

- 5.1 **Kapitali I regjistruar I shoqërisë është 100.000**(nëqind mijë leke), I barabartë me 1 (një) kuote. Kontributet e ortakut përbejnë kapitalin e regjistruar të shoqërisë.
- 5.2 **Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë është në raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotes të secilit ortak, llogaritet në raport me secilin kontribut, e paraqitur në mënyrë të përmbledhur sipas grafikut të mëposhtem:**

Nr.	Emri I Ortakeve	Kuota	Kontributi I ortakëve në kapital (leke)	Përqindja në kapital
1.	XHELAL RRAJA	1	100.000	100%
	Totali	1	100.000	100%

5.3 Kontributet sa me siper jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 6

Zmadhimi dhe Zvogëlimi I Kapitalit Themeltar

- 6.1** Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shtimën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit të ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votive të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.
- 6.2** Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

KREU IV

Neni 7

Transferimi I Kuotave

- 7.1** Transferimi (përfshirë dhe/ose dhurimin dhe/ose cedimin dhe/ose kalimin) inter vivos të kuotave të shoqërisë tek pale të treta i nënshtrohet të drejtës së parblerjes në favour të ortakëve të tjerë ekzistues, të cilët mund ta ushtrojnë këtë të drejtë sipas kushteve të parashikuara në nenin 7.2 më poshtë.
- 7.2** Në rast se një ortak (ketej e tutje i quajtur Ofruesi) kërkon të transferojë disa ose të gjitha kuotat ose kontributet e zotëruara prej tij në shoqëri, ortakët e tjerë (ketej e tutje të quajtur Ortaket e tjerë) gezojnë të drejtën e para blerjes mbi kuotat që ofrohen për transferim (ketej e tutje të quajtur Kuotat të ofruara), sipas afateve dhe kushteve të mëposhtme:
- a. Ofruesi do të dergojë fillimisht ortakëve të tjerë ekzistues një njoftim me shkrim (postë rekomandë) ku të përcaktohet numri i kuotave të ofruara, si dhe cmimin e kuotave të ofruara, emrin e blerësit dhe kushtet e tjera kontraktuale të transferimit (ketej e tutje referuar si oferta) duke ftuar se pari ortakët ekzistues të blejnë keto kuotat e o
- 7.3**
- 7.4** fruara.
- b. Ortaket e tjerë kanë të drejtë të blejnë kuotat e ofruara sipas kushteve të ofertes, në përpjestim me përqindjet e zotëruara, duke i dërguar një njoftim me shkrim ofruesit Brenda një afati 30 ditësh pas marrjes së njoftimit të ofruesit me postë rekomandë.

- 7.5 Ne raste se nje apo disa nga ortaket ekzistues nuk pergjigjen gjate afatit te mesiperme apo pergjigjen ne menyre negative, ateher ofruesi eshte i lire ne transferimin e kuotave ne favour te paleve te treta pa kufizim, me kushtet e njejta si ato te parashikuara ne oferten e mesiperme.
- 7.6 Parashikimet sa me siper nuk zbatohen ne rastin kur kuotat transferohen ndermjet ortakeve ekzistues apo tek personat e paralindur apo paslindur ne vije te drejte te ortakeve ekzistues (femije,bashkeshorte).

Neni 8

Kalimi I kuotave me Trashëgim ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk clirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 8.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotes ose të kërkojë nga shoqëria likuidimin e saj, ne vlere te percaktuar nga ekspert perkates.

KREU IV

Drejtimi dhe administrimi

Organet kryesore drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
- Administratori;
- Drejtuesi Teknik;

Asambleja e Përgjithshme

Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per ceshtjet e meposhtme te Shoqerise:
- a.Percaktimi i politikave tregtare;
 - b.ndryshimet e Statutit;

- c. emerimi dhe shkarkimi I administratorit/administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi I likuiduesve dhe I eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi I skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtareve nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
- g. miratimin I pasqyrave financiare vjetore dhe I raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shqerise;
- h. zmadhimi ose zvogelimi I kapitalit;
- i. pjesetimi I kuotave dhe anulimi I tyre;
- j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykimet dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
- l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;
- m. miratimi I rregullave procedural te mbledhjeve te saj;
- n. ceshtje te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku I vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar. Nëse ortaku I mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.”

- 9.2 Asambleja e Pergjithsme merr vendime per ceshtjet e permendura ne pikat (g) dhe(h) me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates te derguar me thirrjen e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 9.3 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administrator apo ortakët e minorances sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi nëpërmjet një njoftimi me leter rekomande me njoftim marrje te derguar ne adresen e ortakëve apo poste elektronike (email) (adresa te depozituara rregullisht e shoqerise ne te dhenat vullnetare te tij te pakten 7 dite perpara mbledhjes). Njoftimi duhet te kryhet te pakten 7 (shtate) dite te plota perpara dates se caktuar per mbledhjen pervec rasteve kur njoftimi I mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme I cili permban nje afat me te shkurter eshte miratuar nga te gjithe ortakët qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise.
- 9.4 Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te permbaje ne menyre te qarte daten, ditën, kohen, vendin dhe rendin e dites te mbledhjes, se bashku me dokumentacionin perkates dhe do t'u dergohen te gjithe Ortakëve te Shoqerise te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes.

Ne rast ndryshimi te rendit te dites, do te ndiqet e njejta procedure njoftimi qe pershkruhet me siper.

Neni 10
Kuorumi I nevojshem

- 10.1** Në rastin e marrjes së vendimeve të zakonshme, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjigjshme mund të marrë vendime të vlefshme të nëse marrin pjesë dhe janë të pranishëm qofte dhe nepermjet perfaqesuesve të autorizuar, ortakët me të drejtë vote, të cilët zotërojnë jo më pak se 51 përqind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2** Në rastin e marrjes së vendimeve të jashtëzakonshme, që kërkojnë një shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë dhe janë të pranishëm qofte dhe nepermjet perfaqesuesve të autorizuar, ortakët me të drejtë vote, të cilët zotërojnë jo më pak se 51 përqind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.3** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

- 11.1** Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendimet e jashtëzakonshme me anë të votes pro të një shumicë prej $\frac{3}{4}$ të ortakëve pjesëmarrës në mbledhjen e asamblese se përgjithshme rregullisht të mbledhur për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2** Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të zakonshme me anën e votes pro të shumicës të ortakëve pjesëmarrës në mbledhjen e asamblese se përgjithshme, rregullisht të mbledhur, dhe vecanerisht mbi çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabel të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve;
 - e) mbikeqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe tëra porteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - f) perfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;
- 11.3** Ortaku mund të perfaqesohet në asamble të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si perfaqesues të ortakëve në asamble të përgjithshme. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblese se

pergjithshme dhe eshte I vlefshem edhe per mbledhjet vijuese me te njejin rend dite.

- 11.4 Kryetari I mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te jete administrator I shoqerise I cili do te drejtoje mbledhjen dhe asambleja e pergjithshme ne cdo mbledhjet esaj do te emeruje me shumice te thjeshte te votive te ortakeve pjesemarrese dhe nje person tjetër per te mbajtur process-verbalin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 11.5 Cdo vendim I mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te regjistrohet ne process-verbal, I cili do te mbahet ne perputhje me nenin 90 te ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

Neni 12 Votat e Ortakeve

- 12.1 Cdo ortak ka te drejta vote ne perpjesetim me vleren nominale te kuotes se tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votes bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi.
- 12.2 Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asambles së Pergjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

KREU V **Administratori**

Neni 13 Emerimi I Administratorit

- 13.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shume persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikes 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votive te ortakeve ne Asambleja e Pergjithshme, I cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të ropozuar si Administrator.
- 13.2 Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i shoqërisë:
SH.P.S.F , **““RAJA SECURITY ” SH.P.K..**

Z. Xhelal Rraja , I biri I Rexhepit , shtetas shqiptar, lindur ne Zeze, me 13.04.1958 dhe banues ne Rinas , madhore me zotesi te plote juridik edhe per te vepruar, per identitetin e tecilit u garantova me ane te Kartes se Identitetit me

numer personal F80413008Q, per nje afat 5 vjecar, nga momenti regjistrimit te ketij fakti prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1** Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me siper dhe ligjit tregtar ne fuqi.
- 14.2** Pa u kufizuar sa me siper, ne menyre te vecante, Administratori ka keto kompetenca:
- I** Do te drejtoje dhe te perfaqesoje Shoqerine persa i perket administrimit te zakonshem;
 - II** Do te nenshkruaje cdo marreveshje ne emer te Shoqerise;
 - III** Do te hape llogari ne emer te Shoqerise me cdo banke qe kryen aktivitet ne Shqiperi ose jashte saj;
 - IV** Do te pergatise te gjitha planet per marrjen e financimeve, do te nenshkruaje cdo kontrate huaje apo kontrate tjeter qe parashikon njeborxh apo borxh te mundshem per Shoqerine, hipoteke, peng apo cdo marreveshje tjeter qe krijon apo mund te krijojte nje barre mbi pasurite e Shoqerise, marreveshje garancie, kontrakte per shitjen e pasurive te paluajtshme apo te luajtshme te Shoqerise. Te gjitha veprimet e parashikuara ketu (pika IV) do te jene te vlefshmene se jane te autorizuar shprehimisht me ane te nje Vendimi te Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice unanime;
 - V** Do te urdheroje dhe kryeje pagesa ne emer te Shoqerise – duke nenshkruar dokumenta / instrumentet e pagesave;
 - VI** Do te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
 - VII** Do te pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ai paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme;
 - VIII** Do te krijojte nje system monitorimi dhe paralajmerim i njoftimit te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
 - IX** Do te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesa vete Ligjit nr.9723, date 3 Maj 2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;
 - X** Do t’i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi t vecante per veprimtarine e Shoqerise;
 - XI** Do te pergatise te gjitha planet per zhvillimin dhe operimin e Hidrocentraleve;
 - XII** Do te marre ne pune, emeroje, shkarkoje te punesuar te Shoqerise per cdo nivel mperfshire edhe te punesuar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktoje kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do te percaktoje shperblimin e tyre;

- XIII** Te kryeje detyrat, te percaktuara, ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.
- XIV** Do te administroje adresat dhe kontaktet e ortakeve (tel, email). Ne cdo rast ortaket jane te detyruar qe menjehere pas cdo azhornimi te kontakteve te tij (nr.tel, email, adrese shtepie) te njoftoje administratorin me shkrim, ne te kundert mban pergjegjesi per cdo dem te shkaktuar nga mosnjoftimi ne kohe.

Asambleja e pergjithshme, ne baze te nje vendimi te marre me shumicen e percaktuar sa me siper, ka te drejte te ngreje padi perpara gjykates kompetente per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve, si pasoje e shkeljes se rende te ligjit ose te statutit dhe/ose padit e tjera qe parashikon ky ligj ose statute ndaj administratoreve apo ortakeve.

Neni 15

Skualifikim dhe Shkarkimi I Administratorit

Detyra e Administratorit perfundon ne rast se :

- 1 Personi nuk eshte me Administratori sipas parashikimeve te Ligjit perfshire edhe parashikimet e pikes 6 te nenit 95 te Ligjit;
- 2 Personi vuan ose mund te vuaje nga crregullime mendore;
- 3 Ndodhet ose mund te ndodhet ne kushtet e pa-aftesise fizike;
- 4 Jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine;
- 5 Vdekje;
- 6 Ndodhet ne suate apo rrethana te cilat e bejne te pamundur ushtrimin e detyrave te tij;

Neni 16

Kufizimet ne Veprimet e Administratorit

- 16.1** Administratori nuk do te lidh marreveshje per ceshtje ne te cilin ai ka, direct ose indirect, nje interes apo detyrim I cili eshte material, qe eshte apo mund te jete ne kundershtrim me interes e shoqerise, ne pajtim me nenin 13 te Ligjit per shoqerite tregtare, deri ne momentin kur Asambleja e Pergjithshme e shoqerise, ne baze te kuorumit te kerkuar, autorizo lidhjen e kesaj marreveshje.
- 16.2** Autorizimi mund te jete I pergjithshem ose I posacem per nje ceshtje te caktuar. Autorizimi I pergjithshem duhet te regjistrohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Neni 17

Drejtuuesi Teknik

- 17.1** Drejtuesi Teknik I shoqerise eshte Z. **Kujtim Bakalli**, atesia **Dalip**, i datelindjes **25.09.1961**, lindur ne **ne Budull,Kruje** dhe banues ne **Rruga e Lacit,Ndertesa 30, Hyrja 1, Fushekruje**, madhor e me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes I leternjoftimin nr. Personal **G10925161K**, I cili emerohet per nje afat **3 (tre)** vjecare me te drejte riperseritje pervec se palet me shkrim vendosin ndryshe, qe fillon nga momenti I regjitrimit te shoqerise ne QKR.
- 17.2** Drejtues Teknik eshte menaxheri me I larte Teknik per organizimin, drejtimin dhe kontrollin e ketij sherbimi.
- 17.3** Ne cdo rast te largimit te drejtuesit Teknik, titullari I subjektit te njofton menjehere Drejtorine e Pergjithshme te Policise dhe, Brenda 15 diteve, duhet te aplikojte per certifikimin e tij.

Neni 18

Pergjegjesite e drejtuesit Teknik

Drejtuesi Teknik I Sh.p.s.f. eshte pergjegjes per drejtimin, menaxhimin, kontrollin e sherbimit privat te sigurise fizike, te veprimtarise se subjektit, si dhe kryen keto detyra:

- a** Asiston, per aspekte teknike, titullarin e Sh.p.s.f _ ne nenshkrim e marreveshjes apo kontrates me palen kontraktuese per objektin qe merr ne ruajtje shoqeria;
- b** Harton rregullat e funksionimit te Sh.p.s.f, ne lidhje me ruajtjen e objektit;
- c** Eshte pergjegjes per njohjen e punonjesve vartes me legjislacionin perkates dhe per organizimin e trajnimit te tyre;
- d** Perpilon plan-dislokimet me skemat e ruajtjes per cdo object ne ruajtje dhe, per situate emergjente, parashikon plane te vecante;
- e** Eshte pergjegjes per informimin ne kohe te strukturave te Policise se Shtetit, si dhe siguron bashkepunimin e vazhdueshem me to per problem qe lidhen me sigurine e objektit ne ruajtje;
- f** Eshte pergjegjes per planifikimin, organizimin, menaxhimin, kontrollin, inspektimin, perpilimin e dokumentacionit, sigurimin e armatimit dhe te pajisjeve perkatese te sherbimit te sigurise fizike;
- g** Parandalon planifikimin ne sherbim te punonjesit te papajisur me uniforme, armatim dhe pajisje sherbimi;
- h** Merr masa per ruajtjen e vendit te ngjerjes, ne rastin kur ndodh nje veper penale ne territorin e objektit qe ka ne ruajtje, duke njoftuar Policine e Shtetit dhe duke bashkepunuar me te.
- i** Aplikon per riperseritje certificate, ne Policine e Shtetit, 90 dite para dates se perfundimit te afatit.

Neni 19

Marredhenjet e punes

Marredhenjet ndermjet titullarit te subjektit me drejtuesin Teknik, rregullohen sipas legjislacionit ne fuqi.

KREU VI

Prishja dhe njoftimet

Neni 20

Shkaqet e prishjes se shoqerise

- 20.1** Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar priset;
- a** Kur mbaron kohezgjatja, per te cilen eshte themeluar;
 - b** Me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit;
 - c** Ne rast se objekti behet I parealizueshem per shkak te mosfunksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare;
 - d** Ne rastet e pavlefshmerise se themelimit te shoqerise, te parashikuara nga neni 3/1 te ligjit per shoqerite tregtare;
 - e** Ne raste te tjera, te parashikuara ne statut;
 - f** Ne raste te tjera, te parashikuara me ligj;
 - g** Per cdo shkak tjeter te vendosur nga asambleja e ortakeve.

20.2 Ne rast te likuidimit te shoqerise, likuiduesi, ne perputhje me Ligjin dhe me vendimin e marre me shumicen e kualifikuar se votive te Asamblese se Pergjithshme, mund te shperndaje ne dobi te ortakeve te gjitha ose nje pjese te vleres se pasurive te shoqerise dhe per kete qellim, mund te vlersoje cdo pasuri dhe te percaktoje menyren e shperndarjes midis ortakeve te shoqerise.

20.3 Administratori eshte I detyruar te regjistroje prishjen e Shoqerise ne QKR, me perjashtim te rastit kur prishja behet me vendim gjykate; ne kete rast eshte gjykata eshte gjykata qe I degron njoftimin QKR-se.

Neni 21

Njoftimet

21.1 Njoftimet e kryera nga cdo person sipas parashikime vete Statutit, duhet te jene me shkrim ose (nese zbatohet) nepermjet komunikimit elektronik ne adresen e parashikuar sipas pikes 3 te nenit 4 te ketij Statuti dhe jane te vlefshme ne lidhje me kohen e njoftuar per kete qellim dhe personin qe kryen njoftimin.

21.2 Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me leter porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortakët. Kur ka disa bashkëzotues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepën përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të Ligjit.

Neni 22 **Të Ndryshme**

- 22.1** Cdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vlerën e saj.
- 22.2** Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjetër ligjor dhe nenligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohë pas kohë gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 22.3** Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti.
- 22.4** Në fund të cdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilet i dërgohen për miratim Asamblesë së Zakonshme.
- 22.5** Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

Neni 23 **Dispozita përfundimtare**

- 23.1** Ky statut përben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose tërësisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas shumicës së

se cilesuar te percaktuar me siper.

23.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare, me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen Shqip dhe u nenshkrua nga palet pa asnje reserve.

ORTAKU THEMELUES

XHELAL RRAJA

